



NexSys

COMpact



MANUALI I PËRDORIMIT

EnerSys

Power/Full Solutions

CE UK
CA

www.enersys.com

PËRMBAJTJA

Udhëzime sigurie.....	4
Qëllimi i këtij manuali	4
Etiketat	4
Siguria elektrike.....	5
Rekomandimet e CANbus	5
Deklarata e BE	6
Prezantimi dhe përdorimi	6
Hyrje	6
Instalimi mekanik	7
Lidhja elektrike	7
Paneli frontal.....	8
Karikimi	9
Shkarkimi (opsional)	9
Pas karikimit.....	10
Lidhshmëria	10
Kodet treguese	11
Kodet e defekteve	12



Informacioni që gjendet në këtë dokument është shumë i rëndësishëm për trajtimin dhe përdorimin e duhur të baterisë COMpact për të vënë në punë kamionët industrialë elektrikë. Përmban specifikime globale të sistemit, si dhe masat përkatëse të sigurisë, kodet e sjelljes, një udhëzues për vënien në punë dhe mirëmbajtjen e rekomanduar. Ky dokument duhet të ruhet dhe të jetë i disponueshëm për përdoruesit që punojnë me baterinë dhe janë përgjegjës për të. Të gjithë përdoruesit janë përgjegjës për të siguruar që të gjitha aplikimet e sistemit të jenë të përshtatshme dhe të sigurta, bazuar në kushtet e parashikuara ose të hasura gjatë përdorimit.

Ky manual i përdoruesit përmban udhëzime të rëndësishme sigurie. Lexoni dhe kuptoni pjesët lidhur me sigurinë dhe funksionimin e baterisë para se ta vini në punë baterinë dhe pajisjen në të cilën instalohet.

Është përgjegjësia e përdoruesit të sigurohet për përdorimin e dokumentacionit dhe për çdo aktivitet që ka lidhje me to, si dhe të ndjekë të gjitha kërkesat ligjore që zbatohen për veten dhe aplikimet në vendet përkatëse.

Ky manual përdorimi nuk shërben për të zëvendësuar asnjë trajnim lidhur me trajtimin dhe operimin e kamionit industrial ose të baterisë COMpact që mund të kërkohet nga ligjet vendëse dhe/ose standardet industriale. Të gjithë përdoruesit duhet të udhëzohen dhe trajnohen siç duhet para se të kenë kontakt me sistemin e baterisë.

Për shërbime, kontaktoni përfaqësuesin tuaj të shitjeve ose telefononi në:

EnerSys EMEA
EH Europe GmbH
Baarerstrasse 18
6300 Zug, Switzerland
Tel: +41 44 215 74 10

EnerSys Asia
152 Beach Road
#11-08 Gateway East Building
Singapore 189721
Tel: +65 6416 4800

www.enersys.com

Siguria juaj dhe siguria e të tjerëve është shumë e rëndësishme

⚠ PARALAJMËRIM Mund të vriteni ose të dëmtoheni rëndë nëse nuk ndiqni udhëzimet.

UDHËZIMET E SIGURISË

Qëllimi i këtij manuali

Ky manual është bërë për çdo punëtor të aftë që dëshiron të përdorë karikuesit e baterive NexSys[®] COMpact për të karikuar bateri NexSys[®] me acid-plumbi.

- Funksionet e karikuesit.
- Përshtatjet e nevojshme dhe mënyrën e përdorimit të karikuesve.

Gjatë kohës së hartimit të këtij manuali, EnerSys[®] ka pasur si synim ta ofrojë informacionin e tij në një mënyrë sa më të thjeshtë dhe të saktë të mundur, por nuk mund të mbajë përgjegjësi për keqinterpretimet.

Pronarit të pajisjes i kërkohet që ta mbajë këtë manual gjatë gjithë afatit të shërbimit të pajisjes dhe t'ia kalojë blerësit në rast rishitjeje.

Prodhuesi mbulon garancinë në përputhje me rregullat vendëse (kontaktoni organizatën lokale të shitjeve).

Përdorimi i rekomanduar

Ky manual duhet të lexohet me kujdes para përdorimit të pajisjes dhe duhet gjithashtu të lexohet nga kushdo që ka të ngjarë ta përdorë pajisjen.

Pajisja:

- Nuk paraqet asnjë pengesë për qarkullimin e lirë të ajrit përmes vrimës së futjes dhe të daljes së ajrit; megjithatë, një person i kualifikuar duhet të pastrojë çdo gjashtë muaj pluhurin në të.
- Duhet të përdoret në përputhshmëri me nivelin e treguar të mbrojtjes dhe nuk duhet të bjerë asnjëherë në kontakt me ujin.
- Duhet të përdoret brenda limiteve të temperaturës që tregohen te udhëzimet e sigurisë.
- Duhet të instalohet në mënyrë të tillë që gazet nga bateria që po karikohet të mos thithen brenda karikuesit prej ventilatorit.


Siguria e përdoruesit

Merrni të gjitha masat e nevojshme paraprake kur planifikoni ta përdorni pajisjen në zona me rrezik për aksidente. Siguroni ventilim të duhur në përputhje me standardin EN 62485-3 për të lejuar largimin e gazeve të çliruara. Mos e shkëputni asnjëherë baterinë ndërsa është duke u karikuar.

Kjo aparaturë nuk është synuar të përdoret nga persona (përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, të cilët nuk kanë përvojë në përdorimin e saj, përveç rastit kur udhëzohen përkatësisht nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre.

Etiketat

	Artikulli	Përshkrim
S/N	Numri serial	Tregon kodin e datës
U _{ac}	Volt AC	Tensioni nominal për të cilin ky karikues është llogaritur të punojë
I _{ac}	Amp AC	Rryma AC nga rrjeti që duhet për të vënë në punë karikuesin
U _{dc}	Volt DC	Tensioni output DC nominal i karikuesit
I _{dc}	Amp DC	Rryma DC që ky karikues i jep një baterie të shkarkuar me numrin e moduleve të energjisë të instaluar dhe në bazë të tensionit nominal.

EnerSys UK CA CE		
	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
U _{AC}	108 - 132	207 - 265
I _{AC} (A)	7.3 - 6.0	5.9 - 4.6
U _{DC}	24	24
I _{DC} (A)	27	38
Model No.: OB1-1-1-2G / OP-LC		
S/N: ULA001254587		
		
EnerSys Sp. z o.o. ul. Leszczynska 73 43-300 Bielsko-Biala, Poland		

Siguria elektrike

Duhet të ndiqen rregulloret e zbatueshme për sigurinë. Mbrojtja e sistemit e instaluar në bllokun e ushqimit të karikuesit duhet të jetë në përputhshmëri me karakteristikat elektrike të karikuesit. Rekomandohet instalimi i një ndërprerësi të përshtatshëm qarku. Është e domosdoshme të siguroheni që kur të ndërtoni siguresat, të përdoren vetëm siguresa të tipit të specifikuar dhe që kanë vlerën e duhur të rrymës. Ndalohet rreptësisht përdorimi i siguresave të papërshtatshme ose krijimi i qarkut të shkurtër të mbajtësit të siguresave. Kjo pajisje është në përputhshmëri me standardet e sigurisë së kategorisë 1, që do të thotë se aparatura duhet të tokëzohet dhe duhet të furnizohet me energji nga një bllok ushqimi i tokëzuar. Karikuesit e integruar brenda baterisë duhet të garantojnë lidhje të mirë mes konstruktit të baterisë dhe tokëzimit të karikuesit.

Mos e hapni asnjëherë pajisjen: Tensioni i lartë mund të jetë ende i pranishëm, edhe pasi është fikur karikuesi.

Çdo rregullim, mirëmbajtje ose riparim në pajisjen e hapur duhet të kryhet vetëm nga një person me kualifikimin e duhur, i cili është në dijeni të rreziqeve të mundshme.

Kontaktimi një nga teknikët e trajnuar të kompanisë nëse hasen probleme gjatë vënies

së karikuesit në punë. Kjo pajisje është projektuar për përdorim në mjedise të brendshme. Vetëm për karikimin e baterive me acid plumbi në ambiente industriale. Kur pajisja bëhet e papërdorshme, kasat dhe komponentët e tjerë të brendshëm mund të asgjësohen nga kompani të specializuara. Legjislacioni vendas ka përparësi mbi të gjitha udhëzimet në këtë dokument dhe duhet të respektohet rreptësisht (WEEE 2002/96 KE).

EnerSys rezervon të drejtën për të bërë përmirësime dhe/ose modifikime të produktit të përshkruar në këtë manual, në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak, dhe nuk është e detyruar në asnjë rrethanë të përditësojë përmbajtjen e këtij manuali dhe as pajisjen në fjalë.

Duhet të jepni numrin e prodhimit të pajisjes kur kërkonit një shërbim.

Nëse karikuesi duhet të magazinohet para se të përdoret, ai duhet të mbahet i mbyllur me kujdes në ambalazhin e tij origjinal. Ai duhet të ruhet në një vend të pastër dhe të thatë në temperaturë mesatare (20°C deri në +40°C). Pajisjet e ruajtura në temperaturë më pak se 15°C duhet të sillen gradualisht në temperaturë operimi (gjatë një periudhe 24-orëshe) për të shmangur çdo rrezik kondensimim që shkaktojnë defektet elektrike (sidomos qarqet e shkurtra).

Rekomandimet e CANbus

Për çdo instalim CAN, linjat e të dhënave CAN (CAN-H dhe CAN-L) duhet të implementohen me kablllo të posaqme për integritet të mirë të të dhënave. Teli duhet të ketë impedancë karakteristike prej 120 ohm. Gjithashtu duhet të sigurohet energji në kabllon CAN, mundësisht me një çift tjetër të përdredhur për të minimizuar kapjet e zhurmës. Edhe një mburojë e përgjithshme mund të jetë diçka e mirë. Zgjedhja optimale

e kablllos është kablllo 7mm Devicenet CANbus "e hollë", me çifte të përdredhura 24AWG (0.22mm² afërsisht – data) + 22AWG (0.34mm² afërsisht – energji) dhe një veshje e thurur. Përdorimi i këtij kabllli do të bëjë që instalimi të jetë i fortë, të ketë mbrojtje të lartë ndaj zhurmës, rënie të ulët të tensionit në kabllon e energjisë dhe komunikime CAN të besueshme. Përdorimi i kablllove të tjera mund të shkaktojë probleme gjatë operimit.

Deklarata e BE



EnerSys deklaron këtu se karikuesit në gamën NexSys® COMpact që mbuloohen nga kjo deklaratë janë në përputhje me përshkrimet në rregulloret evropiane dhe të Mbretërisë së Bashkuar:

- **Rregullat për pajisjet elektrike (Siguria) 2016 (S.I. 2016/1101)**
- **Direktiva 2014/35/EU:**
Siguria
BS EN IEC 62368-1 : 2020 + All : 2020
- **Rregulloret e EMC 2016 (S.I. 2016/1091)**
- **Direktiva 2014/30/EU:**
Pajtueshmëria elektromagnetike
BS EN IEC 61000-6-2: 2019
BS EN IEC 61000-6-4: 2019
- **Direktiva 2011/65/EU**
ROHS

- **Rregullat për kontrollimin e fushave elektromagnetike (S.I. 2016/588)**
- **Direktiva 2013/35/EU:**
Fushat elektromagnetike
BS EN IEC 62311: 2020
- **Rregullat për pajisjet radio 2017 (S.I. 2017/1206)***
- **Direktiva 2014/53/EU**
ETSI EN 301489-1 V2.1.1 (2017)
ETSI EN 301489-17 V3.1.1 (2017)
ETSI EN 300 328 V2.2.2 (2019)



SHËNIM: Kabllot DC të karikuesit emetojnë fusha elektromagnetike me fuqi të ulët në mjediset që i rrethojnë (<5 cm). Edhe nëse emetimet janë nën kufijtë standardë, personat që kanë implante mjekësore duhet të evitojnë punën në afërsi të karikuesit gjatë karikimit.

Hyrje

Gama e karikuesve NexSys® COMpact bën të mundur që bateritë 24V të karikohen nga rrjeti i energjisë. Kontrolli i mikroprocesorit njih automatikisht tensionin, kapacitetin, gjendjen e karikimit etj. të baterisë, duke siguruar kontroll optimal të baterisë nga një analizë tepër efikase e gjendjes së saj. Ekzistojnë disa profile karikimi, në varësi të konfigurimit të përdoruesit. Shkarkimi i tepërt, ekualizimi dhe karikimet rifreskuese janë gjithashtu të integruara.

Karikuesit mund të lidhen në paralel për të arritur kapacitet më të lartë karikimi. Procesi i karikimi, treguesit dhe lidhjet periferike kontrollohen nga një njësi "Master".

Karikuesi ka opsionin Bluetooth për të komunikuar me pajisjet periferike dhe celulare. Ekzistojnë aplikacione për të konfiguruar dhe ndryshuar parametrat e karikimit dhe për të shkarkuar historinë e karikuesit.

Ekzistojnë disa pajisje periferike opsionale, në varësi të modelit të karikuesit:

- Sensori i temperaturës së baterisë
- Sensori i rrymës
- LED të telekmandës
- Kontakte ndihmëse

Instalimi mekanik

Karikuesi është ndërtuar që të futet te vendi i baterisë brenda pirunit (përdorni gjithnjë pjesë origjinale gome për ta mbajtur karikuesin).

Karikuesi duhet të instalohet në pozicion vertikal për të siguruar qarkullim të ajrit për lart.

Karikuesi duhet të instalohet në mënyrë të tillë që të lihet hapësirë e lirë prej 0,1m qoftë përpara qoftë mbrapa. Duhet të ndërmerret çdo veprim për të mos lejuar riqarkullimin e ajrit ftohës.

Duhet të evitoni zonat ku karikuesit mund të spërkaten me ujë.

Lidhja elektrike

Me rrjetin

Mund të lidhni vetëm një furnizimn rrjeti 1-fazor 230VAC (ose 120VAC, në varësi të konfigurimit nga fabrika) nëpërmjet një prize standarde dhe një ndërprerësi të përshtatshëm (nuk përfshihet). Konsumi i rrymës tregohet në tiketën e informacionit të karikuesit.

Kablo origjinal AC ka një sistem bllokimi (tërhiqeni pjesën e kuqe për ta hequr kabllon nga karikuesi). Sapo të lidhet me rrjetin, dritat LED pulsojnë me radhë për rreth 15 sekonda.

Me baterinë

Duhet të respektohet polariteti. Nëse ndryshohen polaritetet, siguresa digjet, duke ndaluar kështu karikimin, dhe drita LED ndizet në ngjyrë të kuqe.

Referojuni pjesës “Kodet e defekteve”. Karikuesi duhet të lidhet me baterinë nëpërmjet kablllove të ofruara:

- Kablo I KUQ: te terminali POZITIV i baterisë.
- Kablo I ZI: te terminali NEGATIV i baterisë.



Hiqeni kapakun e karikuesit për të pasur qasje te siguresa dhe te lidhjet. Ngaqë është e futur te vendi i baterisë, arka e baterisë do të lidhet me tokëzimin e karikuesit.

Te pajisjet periferike opsionale

Hiqeni kapakun(ët) e konektorit për të pasur qasje te konektorët (të fiksuar me vidë). Lidhni pajisjen(t) tuaj periferike origjinale te vendi i duhur siç tregohet te seksioni i panelit përpara dhe vendosni përsëri kapakun(ët).

PREZANTIMI DHE PËRDORIMI

Paneli i përparmë



Ref	Artikulli	Funksioni 1	Funksioni 2
1	Kapaku i karikuesit	Qasja te lidhjet e kablove DC	Qasja te siguresa e daljes
2	Kapakët e konektorit	Qasja te konektorët periferikë	
3	Vidat e kapakut (x2)	Fiksimi i kapakëve të konektorit	
4	Jastëk gome (x4)	Spacerët M4 mashkull-femër	
5	Qarkullimi i ajrit	Drejtimi nga mbrapa përpara	
6	Porta USB	Shkarko memoriet	Ngarkimi i firmuerit
7	Butoni Start/Stop (▲)	Filloni/ndaloni karikimin	Shkarkimi i historisë
8	Treguesit e gjendjes së karikuesit	E verdhë: Bateria në karikim Gjelbërt: Karikimi përfundoi E kuqe: Defekt në karikim	Kodet treguese dhe të defekteve (shikoni seksionin e posaçëm)
9	Butoni ndihmës (▲▲)	Përditësimi i firmuerit (kombinuar me #2)	Aktivizoni/çaktivizoni modalitetin Bluetooth
10	Kabllo të daljes DC		
11	Konektori i lidhjes	Sensori i rrymës së jashtme (opsional)	
12	Konektori i lidhjes	Porta CANBus (opsionale)	
13	Konektori i lidhjes	Lidhja e karikuesve në paralel (opsionale)	Konfigurimi i karikuesit (nëpërmjet CANbus)
14	Konektori AC input		
15	Konektori i lidhjes	Sensori i temperaturës së baterisë (Poz. 1-2) (opsionale)	Kontaktet ndihmëse (opsionale) Mbrojtja nga shkarkimi i tepërt (Poz. 3-5) Prania e energjisë së rrjetit (Poz. 6-8)
16	Lidhja e tokëzimit	Tokëzimi në trupin e baterisë	
17	Konektori i lidhjes	Dritat LED të telekomandës (opsionale)	
	Sinjalizues (nuk paraqitet)	Treguesi i shkarkimit të tepërt (opsionale)	Treguesi i temperaturës së lartë (opsionale)

karikimit të baterisë

Lidheni karikuesin me energjinë e rrjetit.

Ekran "jo në karikim"

Me karikuesin në modalitetin e pritjes, dritat LED janë të fikura.

Nisja e karikimit

1. Lidhni baterinë. Në konfigurimin standard (AutoStart e aktivizuar), karikimi do të fillojë automatikisht; ose shtypni butonin Start/Stop.

Karikuesi fillon procesin e numërimit mbrapsht (standardi 10s). Gjatë procesit të numërimit mbrapsht, dritat LED e verdhë dhe gjelbërt pulsojnë me radhë, në varësi të profilit të zgjedhur të karikimit.

	LED e gjelbërt	LED e verdhë	LED e kuqe
NXSTND	1 puls	1 puls	OFF
NXFAST	1 puls	2 pulsime	OFF
NXBLOC	1 puls	3 pulsime	OFF

Karikoni baterinë.

Gjatë karikimit, drita LED e verdhë ndizet.

2. Përfundimi i procesit të karikimit

Kur karikuesi përfundon procesin e karikimit, drita LED e gjelbërt ndizet. Ndalojeni karikuesin duke shtypur butonin Start/Pause. Pasi ta shkëputni karikuesin nga energjia e rrjetit, bateria do të jetë gati për përdorim.

Ekualizimi dhe karikimet e rifreskimit

Nisja e ekualizimit dhe karikimeve të rifreskimit tregohet nga një dritë LED e verdhë që pulson.

Shkarkimi (opsionale)

Disa modele karikuesish kanë veçori shtesë të monitorimit të baterisë duke qenë përherë të lidhur me baterinë (kërkohen instalime shtesë). Opsionet e mëposhtme janë të disponueshme vetëm në këto modele.

Mbrojtje nga shkarkimi i tepërt

Mbrojtja nga shkarkimi i tepërt aktivizohet automatikisht gjatë shkarkimit. Kur gjendja e karikimit (State of Charge, SoC) e baterisë është e ulët, kjo tregohet nga sinjalizuesi dhe nga një dritë LED e verdhë që pulson (shiko seksionin për kodet e defekteve). Ka gjithashtu në dispozicion kontakte ndihmëse. Referojuni seksionit "Kontaktet ndihmëse".

Pasi hapet kontaktori për shkak të SoC të ulët, për të shkuar në gjendje karikimi, aktivizoni sërish baterinë duke shtypur butonin e aktivizimit **VETËM NJË HERË**. Pasi ta shtypni një herë, prisni 10 minuta para se ta shtypni përsëri. Gjithsej, mund ta shtypni butonin deri në 4 herë. Pasi e shtypni butonin më shumë se 4 herë, kontaktori do të hapet përfundimisht.

Butonin e aktivizimit



Sensori i rrymës

Një sensor i jashtëm rryme mund të lidhet me karikuesin për të regjistruar të dhënat e shkarkimit.

Pas karikimit

Historia e karikimit

Karikuesi regjistron qindra aspekte të historia e karikimit. Një orë e brendshme bën të mundur llogaritjen e cikleve. Është e mundur të shkarkohet historia e karikimit:

- Karikuesi do të jetë në gjendje joaktive (jo në karikim)
- Lidhni një pajisje ruajtëse USB të karikuesi
- Shtypni butonin Start/Stop (▲) gjatë 5 sekondave
- Sinjalizuesi fillon të bëjë zë
- Lëshoni butonin Start/Stop
- Si drita jeshile, ashtu edhe drita e verdhë ndizen gjatë regjistrimit
- Mund ta hiqni pajisjen ruajtëse USB kur dritat LED fiken

Përditësimi i firmuerit

Nëse është e nevojshme, firmueri mund të përditësohet nëpërmjet portës USB.

Ndiqeni procesin me kujdes:

- Lidhni karikuesin me rrjetin e energjisë
- Karikuesi do të jetë në gjendje joaktive (jo në karikim)
- Lidhni një pajisje ruajtëse USB të karikuesi (me firmuerin për ta ngarkuar)
- Shtypni butonin Start/Stop (▲) dhe butonin ndihmës (▲▲) njëkohësisht gjatë 5 sekondave
- Dritat LED fillojnë të pulsojnë
- Lëshoni butonat
- Firmueri ngarkohet automatikisht (gjatë rreth 10 sekondave)
- Të gjitha dritat LED ndalojnë së pulsuar
- Karikuesi rindizet automatikisht (gjatë rreth 15 sekondave)
- Mund ta hiqni pajisjen ruajtëse USB pasi të përfundojë procesi i inicializimit
- **▲ PARALAJMËRIM** Procesi i karikimit fillon automatikisht pas sekuencës së inicializimit nëse bateria është e lidhur dhe AutoStart është e aktivizuar.

Lidhshmëria

Bluetooth

Gjatë sekuencës së identifikimit të Bluetooth, të gjitha dritat LED pulsojnë shpejt. Modaliteti Bluetooth mund të aktivizohet/çaktivizohet duke shtypur butonin ndihmës (▲) gjatë 5 sekondave (ose nëpërmjet aplikacioneve). Lëshoni butonin, dhe sinjalizuesi bie gjatë 2 sekondave si më poshtë:

- aktivizimi = sinjal me ndërprerje
- çaktivizimi = sinjal pa ndërprerje

CANbus

Si opsion, karikuesi mund të lidhet me një rrjet CANbus, duke mundësuar transferimin e të dhënave në pajisje të jashtme (nevojitet tension rrjeti të jashtëm nga +4,8 to +5,2VDC). Kontaktoni përfaqësuesin tuaj lokal për të marrë informacion të mëtejshëm (referojuni "Rekomandimet e CANbus" për të ditur cila është praktika që duhet të ndiqet gjatë instalimit).


Kontaktet ndihmëse

Përveç nëse tregohet ndryshe, kontaktet ndihmëse sigurojnë funksionet e mëposhtme:

Artikulli	Funksioni	Përshkrim
RL-1	Mbrojtje nga shkarkimi i tepërt	Kur SoC e baterisë arrin nivel kritik, kontakti Normally Open (NO) mbyllet dhe kontakti Normalisht Closed (NC) hapet.
	(E disponueshme vetëm në modelet që mundësojnë lidhjen e përhershme me baterinë).	
RL-2	Prania e energjisë së rrjetit	Kur pajisja është e ndezur, kontakto Normally Open (NO) mbyllet dhe kontakti Normally Closed (NC) hapet.

Lidhshmëria (vazhdim)

Karakteristikat teknike:



Fuqia maks. e shkëmbimit 62VA

Tensioni maks. i shkëmbimit 100VDC

Rryma maks. e shkëmbimit 2A

Për futjen/heqjen e telit, shtypni

sustën në konektor (pjesa portokalli). Në varësi të llojit të ngarkesës (p.sh. ngarkesë induktive), mund të nevojitet mbrojtje shtesë, si për shembull kapacitor(ë) dhe/ose diodë(a). Kontaktet nuk përfshijnë asnjë siguresë; sigurohuni që të shtoni një mbrojtje që prështatshme qarku.

Sensori i temperaturës

Temperatura e baterisë mund të monitorohet duke lidhur një sensor të jashtëm te karikuesi.

Temperaturat e larta tregohen nga aktivizimi i sinjalizuesit dhe/ose nga një dritë LED e verdhë që pulson (referojuni seksionit “Kodet e defekteve”). Sensori duhet të montohet në mes të baterisë (midis pilave). Për futjen/heqjen e telit, shtypni sustën në konektor (pjesa portokalli).

Përdorni vetëm sensor original OEM.

Kodet treguese

○ fikur ● ndezur ★ pulson

Jeshile	E verdhë	E kuqe	Statusi
○	○	○	Nuk ka lidhje me rrjetin. Karikuesi jo në karikim.
↻ ★ → ★ → ★ ↻			Sekuena e inicializimit të karikuesit për 15 sekonda (240VAC).
↻ ★ ★ → ★ ★ → ★ ★ ↻			Sekuena e inicializimit të karikuesit për 15 sekonda (120VAC).
↻ ★ n* ★ ↻		○	Sekuena e numërimit mbrapsht për 10 sekonda (numri i pulsimeve të dritës së verdhë varet nga profili i karikimit).
○	●	○	Karikimi në progres
○	★ Ndezur 2,0 sekonda Fikur 0,5 sekonda	○	Karikimi i rifreskimit ose ekualizimit në progres.
●	○	○	Karikimi përfundoi.
★	○	○	Njësia në modalitetin “Slave”; çdo tregues dhe/ose kod defekti mund të shihet vetëm në njësinë “Master”.
★	★	★	Identifikimi i Bluetooth. Përditësimi i firmuerit (pulsion shpejt ~0,1s).

PREZANTIMI DHE PËRDORIMI

Kodet e defekteve

○ fikur ● ndezur ★ pulson 🔊 sinjal me ndërprerje

Jeshile	E verdhë	E kuqe	Sinjalizuesi	Tregues	Shkaku	Zgjidhja
				DF1*	Karikuesi nuk mund ta karikojë baterinë.	DF1 shfaqet kur karikuesi nuk mund të furnizojë rrymën e tij dalëse. Kontrolloni energjinë e rrjetit. Kontrolloni konfigurimin e karikuesit.
				DF2*	Defekt në output.	Kontrolloni lidhjen e saktë të baterisë (kablo me polaritet kontra) dhe siguresën dalëse.
○	○	●	○	DF3*	Tension i gabuar i baterisë.	Tension i baterisë tepër i lartë ose tepër i ulët. Tensioni i baterisë duhet të jetë midis 1,6 V dhe 2,4 V për qeli.
				TH*	Problem termik në karikues që çon në ndërprerjen e karikimit.	Verifikoni funksionimin e duhur të ventilatorit dhe/ose praninë e temperaturës tepër të lartë të ambientit, ose nëse ka ventilim natyral të dobët në karikues.
				DEF ID*	Karikuesi nuk është kompatibil me konfigurimin e tij.	Kontrolloni konfigurimin e karikuesit. Kontaktoni përfaqësuesin lokal të shërbimit.
○	●	★	○	Gabim LINK	Një njësi në konfigurimin "Master-Slave" nuk punon siç duhet.	Karikuesi është duke punuar në modalitet të degraduar. Rivendosni të gjitha njësitë nga rrjeti i energjisë. Kontaktoni përfaqësuesin lokal të shërbimit.
○	○	★	○	Gabim COM*	Defekt në komunikim brenda karikuesit.	Rivendoseni karikuesin nga rrjeti i energjisë. Kontaktoni përfaqësuesin lokal të shërbimit.
○	↻	★ → ★	○	TH	Problem termik në karikues i cili bën që karikimi të ndalojë.	Prisni derisa karikuesi të ftohet. Procesi i karikimit do të fillojë automatikisht. Kontrolloni temperaturën e ambientit dhe instalimin (ventilimet, pluhurin).
○	●	○	2 🔊 çdo 1 min	Temperaturë e lartë e ambientit ¹	Temperatura e baterisë është e lartë (gjatë karikimit).	Prisni derisa karikuesi të ftohet. Procesi i karikimit do të fillojë automatikisht. Kontrolloni gjendjen e baterisë.
			2 🔊 çdo 1 min	Temperaturë e lartë e baterisë ¹	Temperatura e baterisë është e lartë (gjatë karikimit).	Prisni derisa karikuesi të ftohet. Kontrolloni baterinë. Drita e vedhë fiket kur lidhet me energjinë.
○	★ Ndezur 1/4s Fikur 2s	○	3 🔊 çdo 5 min	SoC e baterisë e ulët ²	Gjendja e karikimit të baterisë është e ulët.	Bateria duhet të ftohet së shpejti. Drita e vedhë fiket kur lidhet me energjinë.
			1 🔊 çdo 5s	SoC e baterisë në gjendje kritike ²	Gjendja e karikimit të baterisë ka arritur një nivel kritik.	Bateria duhet të karikohet menjëherë. Drita e vedhë fiket kur lidhet me energjinë.
				Asnjë funksion	Mungon energjia e rrjetit. Sigura AC është djegur. Bateria nuk është daluar.	Kontrolloni lidhjen me energjinë e rrjetit. Kontaktoni përfaqësuesin lokal të shërbimit. Kontrolloni tensionin e baterisë.
○	○	○	○	Nuk ka komunikim me Bluetooth	Karikuesi nuk gjendet në listën e Bluetooth.	Aktivizoni modalitetin e Bluetooth në pajisjen tuaj. Sigurohuni që pajisja me Bluetooth është e pajtueshme me BLE 4.1. Afrohuni më shumë me karikuesin.

(1) Vetëm nëse është lidhur një sensor i temperaturës

(2) Vetëm në modelet e lidhura përgjithmonë me baterinë.

(*) Një defekt bllokues nuk lejon që karikimi të vazhdojë. Ju lutemi të kontaktoni përfaqësuesin lokal të shërbimit.

SHËNIME

SHËNIME

SHËNIME

www.enersys.com

Objekt i modifikimeve teknike pa njoftim paraprak. E.&O.E.

© 2024 EnerSys. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Markat tregtare dhe logot janë pronë e EnerSys dhe e filialeve të tij, përveç Bluetooth dhe CE, të cilat nuk janë pronë e EnerSys. Objekt i rishikimit pa njoftim paraprak. E.&O.E.

EMEA-AL-OM-NEX-COM-0524

